

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C
ENERGETSKA KOMPANIJA KOSOVA D.D.

Për:
Alper Erbas
Drejtor Menaxhues – KEDS
Serhat Dinc
Drejtor Menaxhues – KESCO
Kopje:
Bordi i KEK-ut

Nga: **Njazi Thaçi**
Drejtor Menaxhues
Korporata Energjetike e Kosovës
Sheshi Nënë Tereza nr. 36
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
www.kek-energy.com

Data: 17.01.2020

TEMA: Propozimi i Çmimeve të energjisë elektrike për periudhën 01 Prill 2020 deri 31 Mars 2021.

I nderuar z. Erbas dhe z. Dinc,

Bazuar në shkresën tuaj të datës 19 Dhjetor 2019, “Ftesë për ofertim të çmimeve” për periudhën rregullative e cila fillon me datën 01 Prill 2020 dhe përfundon më 31 Mars 2021, si dhe vendimit të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut të datës 17 Janar 2020 “Propozimi i Çmimeve të energjisë elektrike për palët”, ju njoftojmë se propozimi final i KEK-ut për çmimet e energjisë elektrike për periudhën në fjalë do të jenë:

- Çmimi i energjisë elektrike për USS (Shërbim Universal) do të jetë **33.30 €/MWh**;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve do të jetë **43.12 €/MWh**;

Gjatë gjithë kohës KEK ka bërë përpjekje maksimale që të ulë shpenzimet operative në masën e dëshiruar dhe deri aty ku nuk cenohet operimi i njësive gjeneruese. Periudha në vazhdim paraqet një periudhë përplot sfida për Korporatën Energjetike të Kosovës duke filluar nga ajo e implementimit të projekteve madhore në TC Kosova B të cilët fillojnë nga ky vit (2020) dhe vazhdon edhe gjatë viteve tjera, zgjerimi i minierës ekzistuese dhe hapja e minierës së re. Për të realizuar këto projekte KEK-u ka nevojë për qëndrueshmëri financiare. Prandaj, çmimet e ofruara më sipër janë ato minimale që ndikojnë direkt në qëndrueshmërinë financiare të korporatës sonë.

Qëndrueshmëria financiare e KEK-ut është me interes vital edhe për palët e interesit dhe për vet sektorin e energjisë në Kosovë. Nëse KEK-u ballafaqohet me vështirësi financiare, atëherë ekziston rreziku i operimit të njësive gjeneruese dhe në këto rrethana mund të ballafaqohemi

ND-TH

me mungesën e energjisë elektrike në sistem e që do të ketë ndikim të madh në koston e energjisë elektrike por edhe në sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

KEK është në dijeni se ka një Marrëveshje për furnizim me shumicë me KEDS dhe KESCO, referuar nenit 5.2.4 e cila obligon KEK që të deklarojë kapacitetin prodhues në dispozicion për KEDS, mirëpo duke marrë për bazë që çmimet e energjisë elektrike nga 01 prill 2017 nuk i nënshtrohen rregullimit nga ZRRE-ja dhe në bazë të udhëzuesit për liberalizim të tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, çmimet e energjisë elektrike duhet të negociohen.

Gjithashtu, në rast të mos arritjes së pajtueshmërisë për çmimin e propozuar më lartë, konform shkresës së ZRRE-së të datës 03 dhjetor 2018 “Trajtimi i energjisë elektrike me shumicë” konform paragrafit 4 të shkresës *“Pjesa e mbetur e energjisë së prodhuar nga KEK do të ofrohet në tregun me shumicë dhe do të bëhet në pajtim me procedurën për tregtimin e energjisë. Sa i përket shitjeve për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, ato duhet të bëhen në pajtim me kontratat e arritura ndërmjet palëve sipas rregullave dhe procedurave në fuqi. Këtu duhet të theksohet se nuk ka trajtim me prioritet por ka respektim të obligimeve kontraktuale dhe vendimeve të ZRRE-së”*, KEK do të ndjek procedurat e shitblerjes së energjisë dhe në bazë të rezultateve të arritura në bazë të kësaj procedura do të përcaktohet fituesi.


KEK është i përkushtuar në përmirësimin e procesit të prodhimit dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike, në këtë frymë, mos mbulimi i koston së energjisë elektrike do ta vë në vështirësi përmbushjen e objektivave të KEK-ut, kërkojmë nga ju, që të analizoni propozimin tonë dhe të pranoni çmimet e energjisë elektrike të cekura më lartë.

Lidhur me propozimin final të cekur më lartë, KEK konsideron që një përgjigje nga ana e KEDS duhet të jepet brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të kësaj shkrese. Pas pranimit të përgjigjes suaj, KEK do të inicioj veprimet konform përgjigjes suaj dhe legjislacionit primar dhe sekondar në fuqi

Me respekt,


Njazi Thaçi

Drejtor Menaxhues



Nj. Th.